

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

**OBJEKTI:** “Riparim I pjesshëm I dhomave të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29”

### **PUNIME PRISHJE**

- 1- Punimet e prishjeve do të përqëndrohen në prishjet e suvatimeve të dëmtuara ekzistuese, pastrami I plotë I mureve si dhe largimi I mbeturinave ndërtimore.

### **PUNIME SUVATIMI**

- 1- Suvatim I plotë brendshëm I mureve dhe tavaneve

Sprucim I mureve dhe tavaneve, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rirforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për t’I dhënë plotësisht fund sprucimit.

Suvatim I realizuar nga një Shtresë me trashësi 2 cm Llaç bastard m-25 me dozim për m<sup>2</sup>: rërë e lare m<sup>3</sup> 0,005, Llaç gëlqereje m-1:2 m<sup>3</sup> 0.03, çimento 400 kg 6.6, ujë, I aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në mure, dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për t’I dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte.

Suvatimi I dhomave do të përfshijë të gjithë sipërfaqen e mureve, tavanëve, hapësira përreth lavamanëve në dhomat e studentëve, duke shmangur gjatë punimeve të gjithë lageshtirën e ndodhur dhe të akumuluar gjatë vitit përreth kësaj hapësire. Në fund të këtij procesi do të verifikohet dhe do të mbahet një proces verbal nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorisë së Shërbimeve Studentore mbi cilësinë dhe specifikimet e vendosura, për të kaluar më pas në proceset e tjera të punës.

### **PUNIME BOJATISJE**

- 1- Bojatisje bojra hidroplastike ose hidromate.

Lemim I suvasë së re me parë me letër zmerile nr.40 ose nr.60 dhe me pas stukum me stuko sintetike në pjesët ku ka nevojë për të patur të gatshme dhe në mënyrë perfekte sipërfaqet për lyerje. Me pas pasi pastrohet nga pluhuri I behet astarimi me astare të gatshme me baze akrilike ose plastike sipas tipit të bojës që do të përdoret. Bojatisje në dyndur me boje në një distancë kohe të nevojshme për tharje të dorës së parë. Sipërfaqja të jetë uniforme dhe pa njolla. Në rastin e lyerjes me gëlqere veprohet si me poshtë: bojatisje në treduar, me qumesht gëlqereje dhe ngjyrat e ndryshme për muret e brendshme, të jashtëme dhe tavane dhe me dozaturë për m<sup>2</sup>: gëlqere e shuar kg 0.55, pluhur ngjyre kg 0.01 si dhe çdo gjë të nevojshme për mbarimin e plote të punës në mënyrë perfekte.

### **PUNIME SHTRESASH**

## 1- Dysheme me pllaka granili

Pllakat do te jene granili sipas përmasave të pllakave ekzistuese. Pllakat do te shtrohen me kolle, mbi nje sipërfaqe me llaç çimento pasi te jete verifikuar nivelimi I saj me nje proces verbal.

Pllakat do te shtrohen sipas riparimeve të pjesshme në vendet e sipërfaqeve të dëmtuara.

### **PUNIME ELEKTRIKE**

Punimet elektrike do të bëhen pjesore, vetëm në pjesët e dëmtuara nga prishja e suvatimit, do të bëhet shtrirja e tubit elektrik dhe përcjellësit që do të dëmtohet, pasi të jetë mbajtur një proces verbal për dëmtimin faktik në çdo dhomë.

Ndriçuesit do të vendosen në tavane, dhe do jene tip pllafonier me llampë led 18w me ndriçim të bardhë.

